



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 486

Datë: 27/2/2023

Zyra e personelit të UP-së

Mbështetur në nenin 16 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP), shpall

KONKURS
për punë praktike në zyrat e shërbimeve administrative të UP-së

Informatat e përgjithshme:

UP ofron për studentët dhe të diplomuarit mundësi angazhimi në punë praktike me pagesë, më qëllim të zbatimit në praktikë të aftësive teorike në fusha të ndryshme profesionale e administrative.

Për këtë qëllim, UP ofron mundësi angazhimi të 160 praktikantëve nën kushtet dhe kriteret si në vijim:

Lartësia e pagesës:	200 euro (bruto) në muaj;
Orari:	Fleksibil, në koordinimin me menaxherin e linjës;
Kohëzgjatja:	Gjashtë (6) muaj (secili grup);
Periodha e angazhimit:	Grupi I: 13.03.2023 – 12.09.2023; dhe Grupi II: 13.09.2023 – 12.03.2024.

Fusha e realizimit të praktikës do të caktohet pas përzgjedhjes, gjegjësisht në vartësi prej profilit të studimeve të kandidatit, nevojave dhe mundësive që ka universiteti.

Praktikantët, pas përfundim me sukses të programit të punës praktike, do të pajisen me certifikatë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".

Kriteret për aplikim:

- Kandidati për punë praktike duhet të jetë student i rregullt ose duhet të ketë kryer studimet në njërin prej njësive akademike të UP-së.
- Përparësi do të kenë kandidatët që nuk kanë përfituar nga programet e mëparshme të praktikës nga institucione ose organizata të tjera.
- Për qëllime të plotësimit të numrit të vendeve të punës praktike, sipas nevojës, UP do të organizojë një intervistë të shkurtër me kandidatët e interesuar.

Kandidatët e interesuar që të jenë pjesë e këtij programi të praktikës profesionale, kërkesën për aplikim duhet ta dorëzojnë në Zyrën e Arkivit Qendror, nr. 18, në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Rr. "Xhorxh Bush", nr. 35, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Kërkesës i duhet bashkëngjitur: vërtetimi për statusin e studentit dhe pasqyra e notave (ose diploma për të diplomuarit), si dhe një CV me të dhënat e kandidatit.

Afati për aplikim: 28.02.2023 deri më 08.03.2023.

